



*Shkoda*

REPUBLIKA E SHQIPËRISË

Universiteti i Shkodrës "Luigj Gurakuqi"

REKTORATI

Nr. 2878 prot.

Shkodër, më 29.09.2023

URDHËR

Nr. 29 datë 29.09.2023

**"PËR KRIJIMIN E KOMISIONIT AD-HOC TË PRANIMIT DHE SHQYRTIMIT TË APLIKIMEVE PËR BURSË DHE PËR PËRJASHTIM REDUKTIV NGA TARIFA VJETORE E SHKOLLIMIT PËR VITIN AKADEMIK 2023-2024 NË PROGRAMET E STUDIMIT TË CIKLIT TË PARË DHE TE DYTE"**

Bazuar në ligjin nr. 80/2015 "Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë", ligjin nr.10296, dt.08.07.2010 "Për menaxhimin financiar dhe kontrollin", i ndryshuar, ligjin nr.9936, datë 26.6.2008 "Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë" (i ndryshuar), Ligjit nr.84/2012 "Për buxhetin e vitit 2023", VKM-së nr.903, dt.21.12.2016 "Për përcaktimin e kriterëve për përfitimin e bursave nga fondi i mbështetjes studentore për studentët e shkëlqyer, studentët që studiojnë në programe studimi në fushat prioritare dhe studentët në nevojë" (i ndryshuar), VKM-së nr 39, dt. 23.01.2019, "Për disa ndryshime në vendimin nr. 903, datë 21.12.2016, të Këshillit të Ministrave "Për përcaktimin e kriterëve për përfitimin e bursave nga fondi i mbështetjes studentore, për studentët e shkëlqyer, studentët që studiojnë në programe studimi në fushat prioritare dhe studentët në nevojë" te ndryshuar",

VKM-së nr.269, datë 29.03.2017 "Për përcaktimin e kategorive të individëve që plotësojnë kriteret e pranimit në një program të ciklit të parë të studimeve, në një program të integruar të studimeve ose në një program të studimeve profesionale, që përjashtohen nga tarifa vjetore e shkollimit"(i ndryshuar), VKM-së nr.40 datë 23.11.2019 Për disa ndryshime dhe shtesa në vendimin nr.269 datë 29.03.2017 të Këshillit të Ministrave për përcaktimin e kategorive të individëve që plotësojnë kriterin e pranimit në një program të ciklit të parë të studimeve, në një program të integruar të studimeve ose në një program të studimeve profesionale, që përjashtohen nga tarifa vjetore e shkollimit(te ndryshuar), VKM-së nr. 251, datë 27.03.2020 "Për një ndryshim në vendimin nr. 269 datë 29.03.2017 të Këshillit të Ministrave "Për përcaktimin e kategorive të individëve që plotësojnë kriteret e pranimit në një program të ciklit të parë të studimeve, në një program të integruar të studimeve ose në një program të studimeve profesionale, që përjashtohen nga tarifa vjetore e shkollimit", të ndryshuar", dhe për reduktim tarife shkollimi VKM-se 780 date 26.12.2018.



**Urdhëroj:**

1. Fillimin e procesit të pranimit të aplikimeve për perjashtim/reduktim dhe trajtimin me bursë për vitin akademik 2023-2024 në programet e studimit të ciklit të parë dhe të dytë.
2. Procesi i aplikimit fillon nga 16.10.2023
3. Krijimin e komisionit AD-HOC të pranimit dhe shqyrtimit të aplikimeve për perjashtimin/reduktimin dhe trajtim me bursë për vitin akademik 2023-2024 në programet e studimit të ciklit të parë dhe të dytë i përbërë nga:

Sehada Abdija	kryetare
Xhenis Zekaj	anëtare
Erisa Ishmaku	anëtare
Nikoleta Frroku	anëtare
Iris Shqarri	anëtare

4. Kryetari i komisionit koordinon punën dhe ngarkon me detyra specifike anëtarët e komisionit.
5. Komisioni shqyrton në bazë të detyrave përkatëse aplikimet e studentëve, harton materialet ve nevojshme për konfirmimet përkatëse si dhe përgatit relacionin shoqërues për bordin e administrimit të USH-se.
6. Komisioni harton materialet e nevojshme për konfirmimet përkatëse e miratimin përfundimtar në Bordin e Administrimit brenda 5 ditëve kalendarike .
7. Komisioni brenda 7 ditëve
8. Bashkëngjitur këtij urdhri Deklaratat që duhet plotësuar nga studenti aplikant .
9. Ngarkohet për zbatimin e këtij urdhri komisioni dhe miratimin e formularëve për aplikim.
10. Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë.

**ADMINISTRATORI**

**REKTORI**

**Admir URUÇI**



**Prof. dr. Rajmonda KËÇIRA**

